

1325 dhe e ardhmja **Garë për ese**

Me rastin e shënimit të 20 vjetorit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (UNSCR 1325 (2000)) UN Women në Kosovë së bashku me Universitetin e Prishtinës dhe Qendrën Burimore për Drejtësi Tranzicionale, organizojnë garën për ese me titull "1325 dhe e ardhmja", garë kjo e cila është e hapur për studentët e Universitetit të Prishtinës.

Informata të përgjithshme

RKSKB 1325 mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë (GPS) u miratua në tetor të vitit 2000. Rezoluta bën thirrje për: (1) rritjen e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së grave në parandalimin e konflikteve dhe proceset e zgjidhjes së konflikteve, përfshirë institucionet e sigurisë; (2) integrimin e perspektivave gjinore në analizën e çështjeve ndërkombëtare të sigurisë; dhe (3) miratimin e masave të veçanta për të mbrojtur gratë dhe vajzat nga dhuna me bazë gjinore në mjediset e konfliktit. Nëntë rezoluta pasuese të Këshillit të Sigurimit të KB kanë përforcuar dhe përmirësuar agjendën e GPS-së.

Megjithëse nuk ka mundësi t'a nënshkruajë rezolutën, Kosova ka bërë progres të rëndësishëm në fushën e Grave, Paqes dhe Sigurisë. UN Women ka mbështetur zbatimin e kësaj rezolute në Kosovë. Gjithashtu, UN Women ka kontribuar në përfshirjen e barazisë gjinore në sektorin e sigurisë dhe gjyqësorit si dhe ka mbështetur organizatat e grave në përpjekjet e tyre për avokim dhe ka zhvilluar aftësitë e tyre në fushën e të drejtave të njeriut që lidhen me gratë dhe ndërtimin e paqes dhe sigurinë. Qeveria është angazhuar për zbatimin e UNSCR 1325 dhe ka rritur mbështetjen e tyre për agjendën mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë përmes hartimit të Planit të parë të veprimit në vitin 2014.

Gara: 1325 dhe e ardhmja

Gara "1325 dhe e ardhmja" synon të nxjerrë në pah strategjitë inovative dhe imagjinare për të arritur objektivat e 1325 në dekadën e ardhshme – vitet 2020-ta. Tri esetë më të mira fituese do të publikohen në faqen e internetit të Ekipit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNKT) dhe në rrjetet e mediave sociale të UN Women në Kosovë dhe Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

Fokusi i eseve - UNSCR 1325 dhe e ardhmja

- Esetë duhet të fokusohen në të kaluarën dhe të ardhmen, konkretisht, në dy dekadat e mëparshme dhe në dekadën e ardhshme. Pyetja është se si të arrihen objektivat e UNSCR 1325 dhe të agjendës mbi GPS në vitet e 2020-ta, duke pasur parasysh sukseset dhe dështimet gjatë dy dekadave të fundit.
- Esetë duhet të përmbajnë rekomandime specifike dhe praktike (realiste) për shoqërinë civile, shtetet dhe / ose organizatat ndërkombëtare. Esetë mund të përqendrohen vetëm në një akter ndërkombëtar (p.sh. shoqërinë civile, një shtet të caktuar ose një grup shtetesh, Kombet e Bashkuara, një organizatë rajonale) ose në një mori akterësh ndërkombëtarë.

Kushtet e pjesëmarrjes

Dorëzimet e eseve janë të hapura për studentët që aktualisht janë të regjistruar në një program Bachelor për vitin akademik 2020 - 2021. Inkurajohen të aplikojnë studentët e të gjitha gjinive.

Kërkesat që duhet t'i plotësojë eseja

1. Esetë duhet të jenë pjesë origjinale e punës së individëve, të pa botuara më herët;
2. Esetë duhet të shkruhen në gjuhën shqipe, serbe, boshnjake, kroate, turke dhe rome dhe të jenë midis 1,000 dhe 1,500 fjalë;
3. Gjatë dorëzimit, duhet të përfshihen edhe: (1) një përmbledhje me 250 fjalë; (2) bibliografia; (3) një biografi të shkurtër; dhe (4) një kopje e regjistrimit në shkollë / universitet;
4. Biografia duhet të përmbajë: a) emrin e plotë të studentit; b) emrin e shkollës ose universitetit dhe programit në të cilin është i regjistruar studentit; c) informatat kontaktuese të studentit (email dhe numrin e telefonit); a Përmbledhja, bibliografia dhe biografia nuk llogariten në numrin maksimal të fjalëve prej 2,000 fjalësh;
5. Esetë duhet të shtypen (me një hapësirë të vetme – single spaced) në fontin Times New Roman me madhësi 12 dhe të dorëzohen në formën Word dhe PDF;
6. Esetë dhe të gjitha pjesët tjera që kërkohen duhet të dorëzohen deri më **20 janar 2021 në mesnatën sipas kohës standarde** përmes aplikimit online.

Kriteret e vlerësimit

Një juri e përbërë nga profesorë të Universitetit të Prishtinës do t'i vlerësojë esetë. Eseja do të vlerësohet në bazë të qartësisë dhe shtjellimit të qartë të argumenteve, si dhe natyrës inovative dhe origjinale të rekomandimeve që lidhen me politikbërjen. Fituesit do të shpallen më **29 janar 2021**.

**Ju lutemi dërgoni aplikacionet tuaja përmes emailit: info.kosovo@unwomen.org
me subjekt: *1325 dhe e ardhmja***